Në bazë të nenit 17, paragrafi (7), të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr.143/19 dhe 14/20) dhe nenit 17 paragrafi, 27, të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.12/19), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në seancën e 36-të të mbajtur më 24.07.2020, miratoi këtë:

R R E G U LL O R E
Për vendet e punës në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Kjo rregullore përcakton numrin e përgjithshëm të nëpunësve administrativë në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (këndej e tutje: Sekretariati i Komisionit Shtetëror), orarin, kodin e pozitës, titullin e pozitës dhe përshkrimin e natyrës së punës në njësitë organizative, si dhe kriteret për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive për vende të caktuara pune.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror përcaktohen në bazë të afërsisë përmbajtësore, ndërlidhshmërisë, llojit, vëllimit dhe shkallës së kompleksitetit, përgjegjësisë dhe kushteve të tjera për kryerjen e tyre.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë rregullore paraqesin bazën për punësimin dhe emërimin e të punësuarve në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror.

Neni 4

Tabela e vendeve të punës është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

II. PLANI DHE PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS PËR NËPUNËSIT ADMINISTRATIVË

Neni 5

Kjo rregullore përcakton dhe përshkruan gjithsej 60 vende pune për nëpunësit administrativë në njësi të ndryshme organizative, në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm të Sekretariatit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, nga të cilat 24 pozita tanimë janë të plotësuara, siç vijon:

Niveli	Numriiparaparësipassistematizimit	Pozicionetëplotësuara
A02	1	1
B01	2	0
B02	4	0
B03	1	1
B04	10	2
C01	28	10
C02	6	3
C03	2	2
C04	3	3
D01	3	2
Gjithsej	**60**	**24**

Neni 6

Kriteret e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për nëpunësit administrativë janë si më poshtë:

- të jetë shtetas I Republikës së Maqedonisë;
- ta flasë gjuhën maqedonase në mënyrë aktive;
- të jetë i moshës madhore;
- të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe
- të mos jetë i dënuar me vendim fuqiplotë gjyqësor me ndalesë për kryerjen e një profesioni, veprimtarie apo detyre.

Neni 7

(1)Kushtet e posaçme të përcaktuara në Ligjin për nëpunës administrativë për zyrtarë të lartë administrate të kategorisë B janë si më poshtë:

a) kualifikimi profesional për të gjitha nivelet – niveli i kualifikimeve VI A, sipas kornizës së kualifikimeve të Maqedonisë dhe të paktën 240 kredi të fituara sipas ECTS-së ose shkallë të përfunduar VII/1;
b) përvojë pune, si më poshtë:
- për nivelin B1 të paktën gjashtë vjet përvojë pune në profesion, nga të cilët të paktën dy vjet në një pozitë menaxhuese në sektorin publik, respektivisht të paktën dhjetë vjet përvojë pune në profesion, nga të cilët të paktën tre vjet në një pozitë menaxhuese në sektorin privat;
- për nivelin B2 të paktën pesë vjet përvojë pune në profesion, nga të cilët të paktën dy vjet në një pozitë menaxhuese në sektorin publik, respektivisht të paktën tetë vjet përvojë pune në profesion, nga të cilët të paktën tre vet në një pozitë menaxhuese në sektorin privatose
- për nivelet B3 dhe B4 të paktën katër vjet përvojë pune në profesion, nga të cilët të paktën një vit në një vend pune në sektorin publik, respektivisht të paktën gjashtë vjet përvojë pune në profesion, nga të cilët të paktën dy vjet në një pozitë menaxhuese në sektorin privat;
c) kompetenca të veçanta të punës për të gjitha nivelet, si më poshtë:
- njohje aktive e njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë administrative dhe
- provim të dhënë për menaxhim administrativ.

(2) Kriteret e përgjithshme për kandidatët enivelit të lartë:
- zgjidhje problemesh dhe vendimmarrje në fushëveprimin e tij/saj;
- mësim dhe zhvillim;
- komunikim;
- realizim rezultatesh;
- punë me të tjerë/punë në ekip;
- vetëdije strategjike;
- orientim drejt nevojave të palëve të interesit;
- udhëheqje dhe
- menaxhim me financa.

Neni 8

(1) Kushtet e posaçme të përcaktuara në Ligjin për nëpunës administrativë për zyrtarë të lartë administrate të kategorisë C janë:
a) kualifikimet profesionale, si më poshtë:
- për nivelin C1, niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës së kualifikimeve të Maqedonisë dhe të paktën 240 kredi të fituara sipas ECTS-së ose shkallë të përfunduar VII/1 dhe
- për nivelet C2, C3 dhe C4 të niveleve të kualifikimeve VI B sipas kornizës së kualifikimeve të Maqedonisë dhe të paktën 180 kredi të fituara sipas ECTS-së ose shkallë të përfunduar VII/1
b) përvojë pune, si më poshtë:
- për nivelin C/1, së paku tre vjet përvojë pune në profesion,
- për nivelinC/2, së paku dy vjet përvojë pune në profesion,
- për nivelinC/3, së paku një vit përvojë pune në profesion, ose
- për nivelinC/4, me apo pa përvojë pune;

c) kompetenca të veçanta për të gjitha nivelet, si më poshtë:
- njohje aktive e njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe
- njohuri aktive e programeve kompjuterike për punë administrative.

(2) Kriteret e përgjithshme për kandidatët e nivelit të mesëm:
- zgjidhje problemesh dhe vendimmarrje në fushëveprimin e tij/saj;
- mësim dhe zhvillim;
- komunikim;
- realizim rezultatesh;
- punë me të tjerë/punë në ekip;
- vetëdije strategjike;
- orientim ndaj nevojave të palëve të interesit dhe
- menaxhim me financa.

Neni 9

(1) Kushtet e posaçme të përcaktuara në Ligjin për nëpunës administrativë për asistent tekniko-profesional i kategorisë D janë:
a) kualifikime profesionale për të gjitha nivelet - niveli i kualifikimeve V A ose niveli i kualifikimeve IV sipas kornizës së kualifikimeve të Maqedonisë dhe 180 ose 240 kredi të fituara sipas ECVET-së ose MKCOO-së apo të paktën arsim të lartë ose të mesëm;
b) përvojë pune, si më poshtë:
- për nivelin D1, së paku tre vjet përvojë pune në profesion;
- për nivelin D2, së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- për nivelin D3, së paku një vit përvojë pune në profesion ose
- për nivelin D4, me apo pa përvojë pune në profesion;
c) kompetenca të posaçme për të gjitha nivelet, si më poshtë:
- njohje aktive e njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe
- njohuri aktive e programeve kompjuterike për punë administrative.

(2) Kriteret e përgjithshme për kandidatët e nivelit bazë:
- mësim dhe zhvillim;
- komunikim;
- realizim rezultatesh;
- punë me të tjerë/punë në ekip;
- orientim ndaj nevojave të palëve të interesit dhe
- menaxhim me financa.

III. PËRSHKRIM I POZITAVE NË SEKRETARIATIN E KOMISIONIT SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Numri rendor	1
Kodi i pozicionit	UPR0101A02000
Niveli	A2
Funksioni	Sekretari i përgjithshëm
Titulli i plotë i pozitës	Sekretari i përgjithshëm
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Kryetarit të Komisionit Shtetëror
Edukimi	Shkenca juridike ose shkenca ekonomike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Menaxhimi efikas dhe efektiv i të punësuarve në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror; -Bashkërendimi i aktiviteteve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit; -Mbështetje për punën e Kryetarit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.
Detyrat dhe përgjegjësitë	-organizon, koordinon, kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin ligjor dhe efikas të detyrave dhe përgjegjësive të Sekretariatit të Komisionit Shtetëror; -menaxhon stafin e Sekretariatit të Komisionit Shtetëror, organizon kolegjiume të rregullta dhe i jep udhëzime personelit menaxhues dhe personelit tjetër administrativ, veçanërisht në kontekst të menaxhimit të burimeve njerëzore; -kujdeset për realizimin e planit strategjik, programin e punës dhe buxhetin e institucionit, zbatimin e vendimeve, konkluzioneve dhe udhëzimeve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit; - kujdeset për rregullsinë dhe saktësinë e shqyrtimit të lëndëve dhe kryerjen e detyrave administrative në institucion, përmirësimin e organizimit dhe kushteve të punës, funksionimin dhe punën e institucionit, si dhe procedurat e standardizuara të punës; - vlerëson vartësit e tij/saj të drejtpërdrejtë në pozita udhëheqëse, dhe sipas nevojës, edhe të punësuarit e tjerë administrativë në njësinë organizative që ai menaxhon; -merr vendime lidhur me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror, kur kjomundësi është e paraparë me ligj; -bashkëpunon me organe të tjera shtetërore, organe të pushtetit lokal, organizata vendase dhe ndërkombëtare në nivelin përkatës, si dhe me përfaqësues të sektorit privat dhe civil;

	-sugjeron dhe këshillon për çështje që lidhen me politikat e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe përfaqësimin e institucionit, përgatit raporte për menaxhimin e institucionit dhe materiale të tjera; - merr pjesë në punën e organeve punuese të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në rastekur është i/e autorizuar nga Kryetari i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Numri rendor	2
Kodi i pozitës	UPR0101B01000
Niveli	B1
Funksioni	Këshilltar shtetëror
Tituli i plotë i pozitës	Këshilltar shtetëror për politika parandaluese antikorrupsion
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Sekretarit të përgjithshëm
Edukimi	Shkenca juridike ose shkenca ekonomike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Ndihmë për menaxhimin efikas, efektiv dhe cilësor të institucionit; -Këshillim dhe udhëzim për kryerjen e analizave dhe hartimin e politikave parandaluese antikorrupsion; -Koordinimin e aktiviteteve që synojnë zbatimin e politikave antikorrupsion.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- kryen detyrat më komplekse për krijimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion që kërkojnë pavarësi dhe ekspertizë të veçantë; -këshillon sekretarin e përgjithshëm për zgjidhjen e çështjeve më komplekse dhe e ndihmon për çështje që lidhen me zbatimin ligjor, efikas dhe në afat të detyrave dhe përgjegjësive të Sekretariatit; -jep kontribut personal në formësimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve për çështje që kërkojnë ekspertizë të veçantë, e që janë nënkompetencatë Komisionit Shtetëror; -promovon koordinimin e përgatitjes dhe zbatimit të strategjive shtetërore dhe dokumenteve të tjera strategjike, projekteve nacionale dhe ndërkombëtare; -mban kontakte në nivel përkatës me institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare; -përgatit vështrime dhe analiza për çështje që lidhen me politika të caktuara dhe me zbatimin e programit të punës së institucionit, për të cilin nevojitet vendimmarrje nga niveli më i lartë i institucionit;

	-jep udhëzime, propozon iniciativa dhe masa për zbatimin efikas dhe efektiv të përmbajtjes së programit të projektuar, të dokumenteve strategjike antikorrupsion dhe raporteve nga fushat në kompetencat e Komisionit Shtetëror; - përgatit propozime, mendime dhe analiza të politikave për çështje themelore në kompetencat e Komisionit Shtetëror; - inicon zgjidhje të çështjeve dhe problemeve të caktuara brenda fushëveprimit të institucionit.

Numri rendor	3
Kodi i pozitës	UPR0101B01000
Niveli	B1
Funksioni	Këshilltar shtetëror
Titulli i plotë i pozitës	Këshilltar shtetëror për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Sekretarit të përgjithshëm
Edukimi	Shkenca juridike ose shkenca ekonomike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Ndihmë për menaxhimin efikas, efektiv dhe cilësor të institucionit; -Këshillim dhe udhëzime profesionale për çështje në lidhje me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit; -Koordinimi i zbatimit të masave dhe aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- kryen detyrat më komplekse për krijimin dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit; -këshillon sekretarin e përgjithshëm për zgjidhjen e çështjeve më komplekse dhe e ndihmon për çështje që lidhen me zbatimin ligjor, efikas dhe në afat të detyrave dhe përgjegjësive të Sekretariatit të Komisionit Shtetëror; - jep kontribut personal për formimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve për çështje që kërkojnë ekspertizë të veçantë, e që janë në kompetencat e Komisionit Shtetëror; -koordinon zbatimin e masave dhe aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave;

	-përgatit analiza, hulumtime, raporte dhe materiale të tjera mbi çështjet ligjore dhe institucionale në lidhje me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave; -mban kontakte në nivel përkatës me institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare; -jep mendime profesionale për ligje dhe dokumente të tjera në kontekstin e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dhe promovimit të integritetit; - përgatit vështrime dhe analiza për çështje që lidhen me politika të caktuara dhe me zbatimin e programit të punës së institucionit,për tëcilin nevojitet vendimmarrje nga niveli më i lartë i institucionit; - inicon zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve të caktuara brenda fushëveprimit të institucionit.

1. DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i Financave	
Numri rendor	4
Kodi i pozitës	UPR0101B04 000
Niveli	B4
Funksioni	Shef departamenti
Titulli i plotë i pozitës	Shefi i Departamentit të Financave
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Sekretarit të përgjithshëm
Edukimi	Shkenca ekonomike ose administratë dhe menaxhim
Kriteret e tjeratë posaçme	
Qëllimet e angazhimit	- Menaxhimi i aktiviteteve të përditshme të Departamentit të Financave dhe realizimi ligjor, efikas dhe në afat të detyrave dhe përgjegjësive; -Zbatimi i rregulloreve ligjore në fushën e operacioneve financiare dhe prokurimeve publike; -Koordinimi i realizimit të buxhetit dhe kontrollin e zbatimit të politikave të përcaktuara dhe menaxhimi financiar operacional.
Detyrat dhe përgjegjësitë	-menaxhon departamentin, organizon, drejton dhe koordinon punën e departamentit, delegon detyrat dhe përcakton përgjegjësitë e të punësuarve në departament dhe kryen kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të zbatimit të detyrave të departamentit; - mbikëqyr kontrollin mbi përgatitjen dhe realizimin e buxhetit, mbikëqyr kontrollin financiar *ex ante*, mbikëqyr gjithë procesin e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, kontrollon zbatimin

	e politikave të përcaktuara dhe menaxhimin operativ,sidhe mbikëqyr kontabilitetin, raportimin për buxhetin dhe financat; - koordinon procesin e përgatitjes, ndryshimit dhe plotësimit të buxhetit, merr pjesë për përgatitjen e planit strategjik të Komisionit Shtetëror, koordinon procesin e zhvillimit, vendos, implementon dhe përkujdeset për menaxhimin dhe kontrollin financiar, si dhe koordinon procesin e kontabilitetit për realizimin e buxhetit dhe përgatitjen e llogarisë vjetore dhe raportit vjetor financiar; - jep mendime për projektligjet e përgatitura nga njësitë e tjera organizative brenda institucionit dhe për projektligjet e institucioneve të tjera që kanë ose mund të kenë implikime financiare për buxhetin e njësisë; - merr pjesë te përgatitja e draftplanit për vendosjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe te zbatimi i kontrollit të gjurmës së auditimit të vendosur nga udhëheqësia e institucionit; - kontrollon përgatitjen e vendimit për shpërndarjen e brendshme të buxhetit total të aprovuar jo më vonë se 10 janari i vitit aktual, të cilin ia paraqet Ministrisë së Financave brenda tetë ditëve nga dita e miratimit të tij; - në rast të ndryshimeve dhe plotësimeve në buxhet, përgatit vendimin e ri për shpërndarjen e brendshme të buxhetit të përgjithshëm të aprovuar, në të cilin, përveç shumave të përcaktuara më parë, përfshihen edhe shumat e ndryshuara; - si person i autorizuar për transaksione, me kërkesë paraprake nga personi i autorizuar për shlyerjet e detyrimeve financiare, jep urdhër për pagesë brenda afateve të përcaktuara me kontratë ose me akte tjera.

Departamenti i Financave	
Numri rendor	5
Kodi i pozitës	UPR0101C01000
Niveli	C1
Funksioni	Këshilltar
Titulli i plotë i pozitës	Këshilltar për kontrollin buxhetor
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca ekonomike
Kriteret e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	- Zbatimi efikas, efektiv dhe cilësor i detyrave më komplekse që lidhen me punën buxhetore, realizimin e buxhetit të Komisionit

	Shtetëror dhe kontrollin financiar; - Zbatimi i pavarur i detyrave dhe përgjegjësivë më komplekse në lidhje me kontrollimin e zbatimit të politikave të përcaktuara buxhetore; - Zbatimi i pavarur i detyrave dhe përgjegjësive më komplekse në lidhje me menaxhimin operacional dhe realizimin e buxhetit.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- mbikëqyr pagesën në kohë të detyrimeve në përputhje me procedurat për shlyerjen e detyrimeve dhe pagesat; - mbikëqyr realizimin e plotë të buxhetit ose realizimin e pjesërishëm të zërave individualë të buxhetit, në bazë të procedurave të miratuara nga udhëheqësi i njësisë; - mbikëqyr raportimin buxhetor dhe financiar; - përgatit analiza, informacione dhe materiale të tjera profesionale-analitike për Komisionin Shtetëror; - mbikëqyr vazhdimisht rregulloret ligjore dhe aktet e tjera të përgjithshme në fushën e operacioneve buxhetore, kontrollin financiar dhe rregulloret e tjera që lidhen me operacionet financiare; - merr pjesë te zbatimi i kontrollit të gjurmës së auditimit të vendosur nga udhëheqësia e institucionit; - kryen kontrollin financiar *ex ante*.

Departamenti iFinancave	
Numri rendor	6
Kodi i pozitës	UPR0101C01000
Niveli	C1
Funksioni	Këshilltar
Titulli i plotë i pozitëës	Këshilltar për prokurime publike
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca juridike ose shkenca ekonomike
Kritere e tjera të posaçme	
Qëlimet e angazhimit	- Zbatimi efikas, efektiv dhe cilësor i detyrave më komplekse për zbatimin e procedurave të prokurimeve publike; -Mbikëqyrja e vazhdueshme e legjislacionit në fushën e prokurimeve publike; - Këshillim dhe udhëzime profesionale lidhur me zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fushën e prokurimeve publike.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- mbikëqyr dhe përcakton nevojën për prokurime publike në Komisionin Shtetëror, përgatit Planin vjetor të prokurimeve publike dhe mbikëqyrrealizimin e planit; - mbikëqyr dhe zbaton legjislacionin në fushën e prokurimeve

	publike dhe përgatit procedurat e brendshme për prokurime publike; - udhëzon dhe këshillon Komisionin e Prokurimeve Publike; - përgatit vendime, kontrata dhe dokumentacion tjetër për qëllimin e kryerjes së prokurimeve publike; - përgatit dhe publikon shpalljet për prokurime publike në SEPP dhe përgatit dokumentacionin e tenderit; - mban evidencë të prokurimeve publike të kryera në Komisionin Shtetëror sipas procedurave të aplikuara në prokurim dhe evidencave të prokurimeve të tjera, po ashtu në bazë të proceduravetë aplikuara, si dhe përgatit kontrata për prokurime publike dhe mbikëqyr zbatimin e tyre; - azhurnon të dhënat e paraqitura në SEPP dhe publikon referencë negative në SEPP, në bazë të kushteve të parapara me Ligjin për prokurime publike; - udhëzon autoritetin kontratues për procedurën e apelimit, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik; - kryen përpunimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera, mbledh, sistematizon dhe trajton materiale për përpunim automatik, në mënyrë që të mbajë evidenca për veprimet financiare të departamentit.

2.DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN ME BURIMET NJERËZORE

Departamenti për Menaxhimin me Burimet Njerëzore	
Numri rendor	7
Kodi i pozitës	UPR0101B04000
Niveli	B4
Funksioni	Shef departamenti
Titulli i plotë i pozitës	Shefi i Departamentit për Menaxhimin me Burimet Njerëzore
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Sekretarit të përgjithshëm
Edukimi	Shkenca juridike, administratë publike ose administratë dhe menaxhim
Kriteret e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	- Menaxhimi i operacioneve të përditshme të Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe realizimin ligjor, efikas dhe në afat të detyrave dhe përgjegjësive; -Zbatimi i kompetencave për zhvillimin e cilësisë së të punësuarve në institucion, zhvillimi i sistemit informatik për burimet njerëzore, marrëdhëniet midis të punësuarve, trajnimi

	dhe avancimi i tyre, motivimi dhe sigurimi i një sistemi të zhvilluar për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror; -Mbikëqyrja e zbatimit të detyrave dhe përgjegjësive të departamentit për të arritur efikasitetin e pritur.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- menaxhon departamentin, organizon, drejton dhe koordinon punën e departamentit, kryen kontroll dhe mbikëqyrje të drejtpërdrejtë mbi realizimin e aktiviteteve, delegon detyrat dhe përcakton përgjegjësitë, ofron ndihmë dhe këshilla profesionale për funksionimin e departamentit, kujdeset për zhvillimin profesional dhe disiplinën e të punësuarve të departamentit; -mban evidencë për mungesat e të punësuarve, vlerëson ato dhe kujdeset për avancimin në karrierë të nëpunësve administrativë në departament; - udhëzon dhe këshillon tëpunësuarit në departament gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive aktuale brenda fushëveprimit të departamentit, dhe posaçërisht për përgatitjen e analizës funksionale, projektligjeve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe përgatitjen e planit vjetor të punësimit; - udhëzon dhe këshillon të punësuarit në departament gjatë zbatimit të procedurave për punësim, përzgjedhje, ngritje në detyrë dhe në transferet e nëpunësve administrativë; - organizon dhe koordinon zhvillimin profesional të nëpunësve administrativë, menaxhon dhe bën matjet e performancës së nëpunësve administrativë, si dhe vlerësimin e efektit të tyre; - kontrollon procedurat e hyrje-daljeve të të punësuarve në hapësirat e Sekretariatit të Komisionit Shtetëror; - mbikëqyr dhe zbaton rregulloret në fushën e burimeve njerëzore dhe siguron ndihmë profesionale për personelin tjetër administrativ në departament; -bashkëpunon me zyrtarë të lartë administrativë të institucionit dhe me zyrtarë tjerë administrativë të nivelit përkatës nga institucionet tjera, për çështje brenda fushëveprimit të njësisë organizative që udhëheq.

Departamenti përMenaxhimin me Burimet Njerëzore	
Numri rendor	8
Kodi i pozicionit	UPR0101C01000
Niveli	C1
Funksioni	Këshilltar
Titulli i plotë i pozitës	Këshilltarpërmenaxhimin me burimet njerëzore
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca juridike, administratë publike ose administratë dhe menaxhim
Kriteret e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Realizimi efikas, efektiv dhe cilësor i detyrave më komplekse në fushën e avancimit të procesit të zhvillimit të burimeve njerëzore; -Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe zbatimi i rregulloreve ligjore dhe akteve të tjera të përgjithshme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore; -Propozimi masave dhe aktiviteteve programore për përmirësimin dhe avancimin e sistemit të burimeve njerëzore.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- merr pjesë gjatë përgatitjes së analizës funksionale dhe hartimit të projektligjeve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror; - merr pjesë gjatë përgatitjes së planit vjetor të punësimit dhe dy herë në vit përgatit raport mbi zbatimin e planit; - merr pjesë në procedurat për punësim, përzgjedhje, ngritje në detyrë dhe në transferet e nëpunësve administrativë, të parapara me Ligjin për nëpunës administrativë; - organizon dhe koordinon zhvillimin profesional të zyrtarëve administrativë, përgatit planin vjetor për trajnimin e të gjithë nëpunësve administrativë në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe dy herë në vit përgatit një raport mbi zbatimin e planit, të cilin ia dorëzon Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës; - merr pjesë në koordinimin e menaxhimit të performancës së nëpunësve administrativë, llogarit vlerësimin vjetor për nëpunësit administrativë dhe përgatit një raport me rangim të vlerësimeve vjetore për të gjithë nëpunësit e vlerësuar administrativë; - merr pjesë në procedurat disiplinore përmes miratimit të një vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurës

	disiplinore, vendimit për shqiptimin e masës disiplinore, si dhe për përgatitjen e një raporti vjetor për masat e shqiptuara lidhur me shkeljen e konstatuar disiplinore dhe materialet e nëpunësve administrativë; -përgatit akte individuale për përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësive të të gjithë të punësuarve brenda fushëveprimit të tyre dhe mbledh të dhëna për mbajtjen e evidencës statistikore dhe të dhënave të tjera që lidhen me të punësuarit në Sekretariatin e Komisionit Shtetëror, dosjet personale të të punësuarve, llojin dhe nivelin e arsimimit të tyre, trajnimet që kanë ndjekur, sistematizimin dhe titujt e të punësuarve në departamente, pushimin vjetor të paguar dhe mungesat e papaguara të të punësuarve, si dhe plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe kushteve të posaçme të punës, të parapara me aktet e përgjithshme që rregullojnë këtë fushë; - mbikëqyr dhe zbaton rregulloret në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

3.SEKTORI PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK DHE INTEGRITET

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Numri rendor	9
Kodi i pozitës	UPR0101B02000
Niveli	B2
Funksioni	Udhëheqës sektori
Tituli i plotë i pozitës	Udhëheqësi i Sektorit për Planifikim Strategjik dhe Integritet
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Sekretarit të përgjithshëm
Edukimi	Shkenca juridike, shkenca ekonomike ose administratë dhe menaxhim
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Zhvillimi, konsolidimi dhe zbatimi ie politikave brenda fushëveprimit të sektorit; -Menaxhimi, organizimi, drejtimi dhe koordinimi i aktiviteteve të sektorit; - Këshillim, udhëzime dhe mbështetje për punën e sekretarit të përgjithshëm për çështje brenda fushëveprimit të sektorit.

Detyrat dhe përgjegjësitë	- menaxhon sektorin, organizon, drejton dhe koordinon punën e sektorit, delegon detyrat dhe përcakton përgjegjësitë e shefave të departamenteve; - mbikëqyr rrjedhën e realizimit të punëve dhe kryen kontroll dhe mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të sektorit; -vepron drejt planifikimit, përgatitjes, organizimit dhe koordinimit të sektorëve/departamenteve të tjera për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe raportimin lidhur me zbatimin e dokumenteve strategjike të miratuara nga Komisioni Shtetëror (plani strategjik, programi vjetor i punës, raporti i punës së Komisionit Shtetëror dhe dokumente të tjera strategjike antikorrupsion); -përgatit analiza dhe informacione lidhur me rezultatet nga realizimi i prioriteteve strategjike, si bazë për përgatitjen e planit strategjik për vitin e ardhshëm; - propozon koncepte, koordinon punën dhe bashkërendon aktivitetet për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave; propozon koncepte, koordinon punën dhe bashkërendon aktivitetet për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave; - propozon dhe koordinon aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të publikut, si dhe promovon integritetin personal dhe institucional; - organizon aktivitete për bashkëpunim me organe dhe institucione nacionale dhe ndërkombëtare dhe për bashkëpunim me organe të tjera shtetërore, shoqata dhe fondacione, institucione shkencore dhe me sektorin privat, në suaza të kompetencave të Komisionit Shtetëror; - koordinon procesin e kontrollit antikorrupsion tëlegjislacionit; -koordinon procesin e realizimit të projekteve; -kujdeset për përgatitjen e raporteve profesionale-analitike.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Numri rendor	10
Kodi i pozitës	UPR0101B03000
Niveli	B3
Funksioni	Ndihmësudhëheqës i sektorit
Titulli i plotë i pozicionit	Ndihmëudhëheqës i Sektorit për Planifikim Strategjik dhe Integritet
Numri i ushtruesve të detyrës	1

I përgjigjet	Udhëheqësit të sektorit
Edukimi	Shkenca juridike, shkenca ekonomike ose administratë dhe menaxhim
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Ndihmë aktive për zhvillimin, bashkërendimin dhe zbatimin e politikave brenda fushveprimit të sektorit; -Ndihmë aktive për menaxhimin, organizimin, drejtimin dhe koordinimin e punës së sektorit - Ndihmë aktive për zgjidhjen e problemeve të caktuara në kompetencat e sektorit në fjalë.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- ndihmon udhëheqësin e sektorit për çështje që lidhen me sigurimin e ndihmës së nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive më komplekse, propozon koncepte për rregullimin e marrëdhënieve, rrethanave dhe çështjeve, si dhe inicon zgjidhjen e problemeve të caktuara në kompetencat e Komisionit Shtetëror; -është përgjegjës për zbatimin ligjor, cilësor dhe në afat të detyrave dhe përgjegjësive; - merr pjesë gjatë përgatitjes dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave; - ndërmerr aktivitete për planifikimin, përgatitjen, organizimin dhe koordinimin e sektorëve/departamenteve të tjera për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe raportimin mbi zbatimin e dokumenteve strategjike të miratuara nga Komisioni Shtetëror (plani strategjik, programi vjetor i punës, raporti i punës së Komisionit Shtetëror dhe dokumente të tjera strategjike antikorrupsion); - merr pjesë gjatë përgatitjes së analizave dhe informacioneve mbi rezultatet e realizimit të prioriteteve strategjike, si bazë për përgatitjen e planit strategjik për vitin e ardhshëm; -propozon dhe koordinon aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të publikut, si dhe aktivitete për zbatimin dhe promovimin e integritetit personal dhe institucional; - organizon a ktivitete për realizimin e bashkëpunimit me organet dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, organet shtetërore, shoqatat dhe fondacionet, institucionet shkencore dhe sektorin privat; - koordinon procesin e kontrollit antikorrupsion të legjislacionit; -koordinon procesin e realizimit të projekteve;

	- jep kontribut profesional gjatë përgatitjes së raporteve analitike.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Departamenti për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dhe Edukim	
Numri rendor	11
Kodi i pozitës	UPR0101B04000
Niveli	B4
Funksioni	Shef departamenti
Titulli i plotë i pozitës	Shefi i Departamentit për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dhe Edukim
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Udhëheqësit të sektorit
Edukimi	Shkenca ekonomike, administratë dhe menaxhim ose shkenca juridike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Menaxhimi efikas, efektiv dhe cilësor i operacioneve të përditshme të Departamentit për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dhe Edukim; -Koordinimi i aktiviteteve për të arritur qëllimet strategjike të Komisionit Shtetëror, përgatitja dhe implementimi i dokumenteve strategjike, realizimi i bashkëpunimit, realizimi i projekteve, përpunimi statistikor i të dhënave, analitika dhe edukimi; - Mbikëqyrja e detyrave dhe përgjegjësive të departamentit për të arritur efikasitetin e kërkuar.
Detyrat dhe përgjegjësitë	-menaxhon departamentin, organizon, drejton dhe koordinon punën e departamentit, delegon detyrat dhe përcakton përgjegjësitë e të punësuarve në departament, si dhe kryen kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të realizimit të detyrave të departamentit; - planifikon, përgatit, organizon dhe koordinon sektorët/departamentet e tjera për përgatitjen e planit strategjik, programit vjetor të punës, raportit të punës së Komisionit Shtetëror dhe dokumenteve të tjera strategjike antikorrupsion, si dhe për përgatitjen e raporteve për zbatimin e dokumenteve strategjike që miraton Komisionin Shtetëror, si bazë për planifikimin strategjik për vitin e ardhshëm; - punon për përgatitjen e metodologjisë për hartimin e strategjisë nacionale, dhe koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e Strategjisë

	Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave; - merr pjesë në procesin e përgatitjes dhe azhurnimit të metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve për korrupsion, koordinon dhe mbikëqyr procesin e vlerësimit të rreziqeve për korrupsion në nivel shtetëror dhe institucional, si dhe përgatit analiza për rreziqet për korrupsion në sektorë të ndryshëm; - koordinon përgatitjen e raporteve, analizave, informacioneve dhe materialeve të tjera në lidhje me të dhënat e mbledhura nga funksionimi i institucionit dhe funksionimi i secilës njësi veç e veç; -kujdeset për përgatitjen e dokumenteve që definojnë mënyrën e realizimit të bashkëpunimit (memorandume, protokolle etj.), për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre dhe për pjesëmarrjen në aktivitete për realizimin e bashkëpunimit bilateral dhemultilateral ndërinstitucional dhe ndërkombëtar; - koordinon procesin e realizimit të projekteve; -organizon sondazhe të opinionit publik për të vlerësuar punën e Komisionit Shtetëror dhe gjendjen aktuale lidhur me korrupsionin dhe konfliktin e interesave; -planifikon, organizon, koordinon dhe realizon fushata për ngritjen e vetëdijes publike për korrupsionin dhe konfliktin e interesave, si dhe mundëson edukimin antikorrupsion; -merr pjesë në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të konceptit të integritetit.

Sektori për Planifkim Strategjik dhe Integritet	
Departamenti për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dhe Edukim	
Numri rendor	12
Kodi i pozitës	UPR0101C01000
Niveli	C1
Funksioni	Këshilltar
Titulli i plotë i pozitës	Këshilltar për statistika dhe analitikë
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca ekonomike ose statistikë
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	- Zbatimi efikas, efektiv dhe cilësor i detyrave më komplekse të punës, që lidhen me realizimin e analizave dhe përpunimin statistikor të të dhënave;

	- Organizimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me qëllim të mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave; - Realizimi i pavarur i detyrave dhe përgjegjësive më komplekse në lidhje me përgatitjen e raporteve analitike dhe statistikore.
Detyrat dhe përgjegjësitë	-mbledh të dhëna nga departamentet e tjera të Sekretariatit të Komisionit Shtetëror dhe i përpunon ato; -kryen vështrime analitike dhe përgatit raporte për nevojat e Komisionit Shtetëror; -përgatit analiza, analizon shënime, informacione dhe raporte; -përgatit raporte analitike të veçanta dhe të përgjithshme; - koordinon procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për zbatimin e konceptit të integritetit në institucione; -përgatit kontroll dhe raporte për shkallën e zbatimit të konceptit të integritetit në institucione.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Departamenti për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dhe Edukim	
Numri rendor	13
Kodi i pozitës	UPR0101C01000
Niveli	C1
Funksioni	Këshilltar
Titulli i plotë i pozitës	Këshilltar për bashkëpunim dhe projekte
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca ekonomike, administratë dhe menaxhim ose shkenca politike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Zbatimi efikas, efektiv dhe cilësor i detyrave më komplekse të punës brenda fushëveprimit të departamentit, që kontribuojnë për realizimin e bashkëpunimit të caktuar dhe projekteve të planifikuara; - Organizimi dhe evidentimi i ngjarjeve në funksionin e realizimit të bashkëpunimit; - Pjesëmarrja gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve dhe projekteve.
Detyrat dhe përgjegjësitë	- koordinon aktivitetet dhe realizon bashkëpunimin me organet e tjera shtetërore për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave;

	-merr pjesë gjatë përgatitjes së memorandumeve të bashkëpunimit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre; - organizon ngjarje ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve dhe delegacioneve të Komisionit Shtetëror në ngjarjet ndërkombëtare; - mban evidencë për takimet e punës dhe ngjarjeve të tjera në funksion të jetësimit të bashkëpunimit; - mban evidencë për pjesëmarrjen, udhëtimet zyrtare dhe vizitat e përfaqësuesve të Komisionit Shtetëror në ngjarjet rajonale dhe ndërkombëtare; - bashkëpunon me shoqatat dhe fondacionet, institucionet shkencore dhe sektorin privat në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, në suaza të aktiviteteve programore të Komisionit Shtetëror; -koordinon aktivitetet për realizimin e bashkëpunimit në bazë të memorandumeve të nënshkruara dhe protokolleve të bashkëpunimit; - merr pjesë gjatë organizimit të aktiviteteve dhe përgatitjes së materialeve për seminare, konferenca, debate publike dhe ngjarje të tjera në lidhje me realizimin dhe promovimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar; - inicon dhe merr pjesë gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve dhe projekteve të mbështetura nga subjektet vendore dhe ndërkombëtare, dhe përgatit informacione në lidhje me realizimin e aktiviteteve të projektit.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Departamenti për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dheEdukim	
Numri rendor	14
Kodi i pozitë	UPR0101C01000
Niveli	C1
Funksioni	Këshilltar
Titulli i plotë i pozitës	Këshilltar për edukim, për ngritjen e vetëdijes publike dhe për zhvillimin e konceptit të integritetit
Numri i ushtruesve të detyrës	1

I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca politike ose shkenca juridike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Zbatimi efikas, efektiv dhe cilësor i detyrave më komplekse të punës që lidhen me planifikimin, organizimin dhe realizimin e edukimit, fushatave për ndërgjegjësimin e publikut për korrupsionin dhe konfliktin e interesave, si dhe zhvillimi dhe zbatimi i konceptit të integritetit; - Organizimi i trajnimeve dhe analizimi i nevojave për zbatimin e tyre; - Përgatitja e materialeve për realizimin e sondazheve të opinionit publik dhe fushatave për ngritjen e vetëdijes publike për korrupsionin dhe konfliktin e interesave.
Detyrat dhe përgjegjësitë	-koordinon sektorët dhe departamentet e tjera në procesin e përgatitjes së planeve dhe programeve të trajnimit dhe përgatitjen e materialeve për realizimin e trajnimeve; - përgatit plane, programe dhe materiale për trajnime; - mban evidencë dhe analiza me qëllimin e përpilimit dhe zhvillimit të një koncepti edukativ për nevojat e grupeve të caktuara; - organizon dhe zhvillon trajnime dhe përgatit raporte dhe kontroll në lidhje me organizimin dhe zbatimin e trajnimeve; - përgatit materiale për realizimin e sondazheve të opinionit publik për të vlerësuar punën e Komisionit Shtetëror dhe gjendjen lidhur me korrupsionin dhe konfliktin e interesave; -përgatit materiale për planifikimin, organizimin, koordinimin dhe realizimin e fushatave të vetëdijësimit të opinionit publik mbi korrupsionin dhe konfliktin e interesave; -merr pjesë gjatë zhvillimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të integritetit institucional dhe elementeve të tij; - përgatit analiza për shkallën e zbatimit të konceptit të integritetit.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Departamenti për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dhe Edukim	
Numri rendor	15
Kodi i pozitës	UPR0101C02000
Niveli	C2
Funksioni	Bashkëpunëtor i lartë

Titulli i plotë i pozitës	Bashkëpunëtor i lartë për planifikimin strategjik dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca juridike, shkenca ekonomike ose shkenca politike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Realizimi i detyrave komplekse të punës në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e dokumenteve strategjike të institucionit; -Pjesëmarrja në aktivitetet për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit; -Përgatitja e materialeve në lidhje me analizën e rrezikut për korrupsion në sektorë të ndryshëm.
Detyrat dhe përgjegjësi	- përgatit dhe koordinon sektorët/departamentet e tjera për përgatitjen e planit strategjik, programit vjetor të punës, raportit të punës së Komisionit Shtetëror dhe dokumenteve të tjera strategjike antikorrupsion; - përgatit draft-tekstin e planit strategjik, programin vjetor të punës, raportin e punës së Komisionit Shtetëror dhe dokumentet e tjera strategjike antikorrupsion; - përgatit draft-raporte për zbatimin e dokumenteve strategjike të miratuara nga Komisioni Shtetëror; -mbikëqyr zbatimin e Strategjisë Kombëtare, përpunon të dhënat dhe përgatit raporte dhe analiza përmbledhëse për nivelin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare; -koordinon dhe zbaton aktivitetet për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare dhe merr pjesë gjatë organizimit të aktiviteteve dhe ngjarjeve lidhur me këtë strategji; -ndihmon përgatitjen e akteve të tjera që kanë të bëjnë me Strategjinë Kombëtare; -mbikëqyr procesin e vlerësimit të rrezikut për korrupsion në nivel shtetëror dhe institucional; -merr pjesë gjatë përgatitjes së analizave të rreziqeve për korrupsion në sektorë të ndryshëm.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Departamenti për Planifikim Strategjik, Bashkëpunim, Projekte, Analitikë dhe Edukim	
Numri rendor	16
Kodi i pozitësd	UPR0101C04000
Niveli	C4
Funksioni	Bashkëpunëtor i ri
Titulli i plotë i pozitës	Bashkëpunëtor i ri për analitikë
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca juridike , shkenca ekonomike ose statistikë
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	-Kryerja e detyrave më të thjeshta rutinore në lidhje me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitja e raporteve analitike; -Mbledhja e të dhënave dhe ndihma për përgatitjen e analizave, kontrolleve, informacioneve dhe raporteve; -Ndihmë në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të konceptit të integritetit në institucione.
Detyrat dhe përgjegjësitë	-mbledh të dhëna nga departamentet e tjera të Sekretariatit të Komisionit Shtetëror, i analizon ato dhe përgatit raporte; -ndihmon gjatë përgatitjes së procesverbaleve dhe analizave, informacioneve dhe raporteve, si dhe për përgatitjen e raporteve analitike; - ndihmon azhurnimin e të dhënave të përfshira në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave; - ndihmon përgatitjen e kontrollit të të dhënave të nevojshme për vlerësimin e Strategjisë Kombëtare; - ndihmon procesin e mbledhjes së të dhënave për zbatimin e konceptit të integritetit në institucione; -ndihmon përgatitjen e kontrolleve dhe raporteve mbi zbatimin e konceptit të integritetit në institucione; - ndihmon kontrollin e të dhënave të regjistruara me kontroll logjik.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe Integritet	
Departamenti për Kontrollin Antikorrupsion të Legjislacionit	
Numri rendor	17
Kodi i pozitës	UPR0101B04000
Niveli	B4

Funksioni	Shef departamenti
Titulli i plotë i pozitës	Shefi i Departamentit për Kontrollin Antikorrupsion të Legjislacionit
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Udhëheqësit të sektorit
Edukimi	Shkenca juridike
Kushtet e tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	- Menaxhimi efikas, efektiv dhe cilësor i punës së përditshme të Departamentit përKontrollin Antikorrupsion; -Zhvillimi, bashkërendimi dhe koordinimi i politikave brenda fushëveprimit të departamentit, me qëllim të zbatimit të procesit për kontrollin antikorrupsion të legjislacionit; -Mbikëqyrja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të departamentit për të arritur efikasitetin e pritur.
Detyrat dhe përgjegjësi	- menaxhon departamentin, organizon, drejton dhe koordinon punën e departamentit, delegon detyrat dhe përcakton përgjegjësitë e të punësuarve në departament dhe kryen kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të departamentit; - delegon drejtpërdrejt detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve në departament, sipas kompleksitetit dhe karakterit të lëndës; - delegon udhëzime, zbaton udhëzimet e pranuara dhe jep këshilla profesionale lidhur me detyrat në departament; - kryen kontroll dhe mbikëqyrje të drejtpërdrejtë mbi realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të departamentit, si dhe kujdeset për realizimin efikas dhe në afat të detyrave dhe përgjegjësive në departament; -kujdeset për të ndërmarrë veprimet e duhura brenda afatit të paraparë, për përgatitjen e dokumenteve dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në metodologjinë për kontrollin antikorrupsion të legjislacionit; - jep udhëzime dhe merr pjesë në zbatimin e të gjitha fazave të procesit të kontrollit antikorrupsion të legjislacionit, në përputhje me metodologjinë për kontrollin antikorrupsion të legjislacionit; - kryen drejtpërdrejt detyra dhe përgjegjësi komplekse në departament, si dhe përgatit vështrime profesionale për tema komplekse që kërkojnë ekspertizë dhe objektivitet të veçantë; -merr pjesë në grupe pune ndërministrore që trajnohen për përgatitjen e legjislacionit;

	- përgatit raporte periodike me rekomandime për procedimet në të ardhmen.

Sektori për Planifikim Strategjik dheIntegritet	
Departamenti për Kontrollin Antikorrupsion të Legjislacionit	
Numri rendor	18
Kodi i pozitës	UPR0101C01000
Niveli	C1
Funksioni	Këshilltar
Titulli i plotë i pozitës	Këshilltar për kontrollin antikorrupsion të legjislacionit në sferën e financave publike, sistemit financiar, përkrahjes dhe ndihmës financiare
Numri i ushtruesve të detyrës	1
I përgjigjet	Shefit të departamentit
Edukimi	Shkenca juridike
Kushtete tjera të posaçme	
Qëllimet e angazhimit	- Zbatimi efikas, efektiv dhe cilësor i detyrave më komplekse për realizimin e kontrollit antikorrupsion të ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të përgjithshme, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Komisioni Shtetëror; - Mbikëqyrja e vazhdueshme e rregulloreve ligjore dhe akteve të tjera të përgjithshme, dhe identifikimi i rreziqeve ligjore për korrupsion dhe konflikt të interesave; - Përgatitja e draft-raporteve dhe rekomandimeve për eliminimin e rreziqeve për korrupsion ose konflikt të interesave në legjislacion.
